

DOKUDAILY

NUMRI I KATËRT

EDICIONI XXIV

E HËNË 4 GUSHT 2025

Rekomandime

Faqe 03

Intervistë

Faqe 05

Mbi filmat

Faqe 08

FOTO: FERDI LIMANI

KULTURA SI REZISTENCË

“Dokufest nisi sepse ishte e nevojshme. Ne e rimorëm Kino Lumbardhin për të shfaqur filma, në një qytet që nuk kishte një kinema.”

Kjo fjali e thënë nga drejtori artistik i Dokufest, Veton Nurkolari, gjatë panelit të djeshëm të DokuTalks mbi hapësirat publike si formë e rezistencës kulturore, mbeti në mua. Ai po i përgjigjej një pyetje nga audienca mbi impaktin e një festivali filmi përtej shfaqjes së filmave. “Prej se, - vijoi ai, - ne jemi rritur duke ndërtuar programe që i përgjigjen nevojave të komunitetit tonë.”

Në këtë panel bashkë me të ishin organizatorë kulturorë si Rozafa Maliqi (nga ekipi i Termokiss në Prishtinë), Luka Knežević Strika (bashkëthemelues i Magacin në Beograd dhe Valentina Bonizzi (artiste dhe anëtare e grupit ATA në Kamëz) e diskutimi ynë u përqëndrua se si hapësirat publike mund të transformohen në organizimi që udhëhiqen prej komunitetit, që janë të qasshme dhe të pavarura.

Një temë përvijuese e diskutimisht ishte dhe trashëgimia. Kush e çel udhën para? Si mundemi të vijojmë? Dhe cilat janë impaktet afatgjata që dikush mund të ketë në komunitetet në të cilat shërben?

Që kur kam nisur të punoj disa vite më parë në DokuFest, kam kuptuar dhe jam mahnitur se sa influencë të rrënjosur dhe jetëgjatë ka ky organizim në jetën kulturore në Kosovë.

E nuk flas vetëm për periudhën kur zhvillohet festivali, por për njerëzit në të dhe më gjërë:

Prej Alba Çakallit, tanimë producente e festivalit, dhe Malbora Krajkut e cila është menaxhere e projekteve, të cilat e kanë nisur rrugëtimin e tyre në këtë festival si vullnetare mbi një dekadë më parë, tek filmbërës si Leart Rama dhe Norika Sefa që kanë zhvilluar filmat e tyre të parë si studentë në Future is Here. Te filmbërës si Hana Ahmeti dhe Blerta Haziraj, që i janë bashkangjitur festivalit vite më parë, te shumë vullnetarë të rinj të cilët kthehen vit pas viti sepse duan çka bëjnë, apo ata të cilët i janë bashkangjitur programit edukativ Future is Here për të bërë filmin e tyre të parë.

Prej 23 vitesh, DokuFest e ka zgjeruar hapësirën për të mirëpritur njerëz, shumë më shumë se sa thjesht një vend ku shfaqen filma. Trashëgimia e DokuFest gjendet te njerëzit të cilët i ka rritur: te ata për të cilët është përkujdesur, janë “stërvitur” këtu, kanë gjetur mbështetje dhe kanë gjetur sy të cilët i shohin për atë që janë. Ky është thelbi i rezistencës kulturore. E kjo gjendje kërcënohet lehtësisht kur kultura nënçmohet, kur fondet priten dhe kur programet nuk vijnë më.

E sërish, pavarësisht të gjithave, puna vijon. Sepse ende ka nevojë. E unë besoj se gjenerata e re është mëse gati ta çojë këtë përpjekje para.

Deri atëherë, Eroll, Veton, Linda, Samir dhe gjithë ekipit të Dokufest - ju faleminderit që na e rrëfeni udhën.

Shkruar nga Dea Gjinovci



REKOMANDIME

SAY GOODBYE / 103'
HUMAN RIGHTS DOX



SHTËPIA E KULTURËS (SALLA E VOGËL) 18:30

CUTTING THROUGH ROCKS / 95' -
VIEW FROM THE WORLD



KINO ABI ÇARSHIA 20:00

A STRANGE COLOUR OF DREAM / 74'
BALKAN DOX



KINO ABI ÇARSHIA 20:00

O-BI, O-BA: THE END OF CIVILIZATION / 74'
BLAST FROM THE PAST



SHTËPIA E KULTURËS (SALLA E MADHE) 21:00

NOBODY'S BUYING YOUR SHORT:
SO WHAT NOW?
DOKUTALKS



SHKOLLA E MUZIKËS 'LORENC ANTONI' 17:00

DAKHA
BRAKHA
DOKUNIGHTS



SONAR STAGE 22:30

MBI FORUMIN E FILMIT TË SHKURTËR

Një platformë e re rajonale për produksione të përbashkëta



FOTO: LUKA STRIKA

Me inaugurimin e Forumit të Filmit të Shkurtër në edicionin e 24-të të DokuFest-it u shënua një moment kyç për kinemanë rajonale, një platformë novatore që i dedikohet mbështetjes së produksioneve të përbashkëta dhe bashkëpunimit krijues mes regjisorëve në zhvillim nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut. Ky Forum u hap zyrtarisht të hënën në Shkollën e Muzikës “Lorenc Antoni” në Prizren, duke sjellë një kapitull të ri në zhvillimin e rrëfimit të shkurtër në Ballkan.

Me tetë projekte të përzgjedhura të cilat janë në zhvillim, dhe që përfshijnë animacion, dokumentar, fiksion, hibrid dhe eksperimental, Forumi i Filmit të Shkurtër synon të kultivojë një kulturë shkëmbimi, mentorimi dhe sinergjie rajonale. Iniciativa është parashikuar si një trampolinë për zëra të rinj, duke u ofruar atyre mjetet dhe rrjetin e nevojshëm për të lulëzuar në një peizazh kinematografik gjithnjë e më global.

Në hapje, Eroll Bilibani nga DokuFest e përshkroi Forumin e Filmit të Shkurtër si realizimin e një ëndrre të kamotshme, të frymëzuar nga modeli nordik i bashkëpunimit kinematografik.

“Ky është moment shumë i rëndësishëm për DokuFest, që kjo ëndërr po bëhet realitet, Forumi i parë i Filmit të Shkurtër për produksione të përbashkëta në Ballkan,” tha Bilibani. “Neve na frymëzoi mënyra si bashkëpunojnë vendet nordike dhe si i mbështesin filmat e shkurtër përtej kufijve. Edhe pse nuk kishim burime për të nisur atëherë, ideja mbeti si një farë që priste të rritej”.

Koncepti mori formë gjatë viteve përmes hapave të vegjël, përfshirë grantet për atë që Bilibani e quajti Valën e re të regjisorëve. Impulsi i vërtetë nisi të ndërtohej kur diskutimet me Institutin Suedez të Filmit dhe mbështetja e vazhdueshme nga Ambasada Suedeze në Prishtinë dhe SIDA e shndërruan vizionin në realitet.

“Jemi shumë mirënjohës, zotëri Westerlund, për mbështetjen e Ambasadës”, shtoi Bilibani, duke e pranuar rolin katalitik të Suedisë në sigurimin e financimit. “Kjo inkurajoi edhe Ministrinë e Kulturës së Kosovës që t’i bashkohej mbështetjes dhe të ndihmonte në sjelljen në jetë të këtij Forumi”.

Duke përfaqësuar një nga mbështetësit kryesorë të Forumit, Jonas Westerlund, Ambasador i Suedisë në Kosovë, foli ngrohtësisht në ceremoninë e hapjes, duke theksuar fuqinë e filmit për të nxitur mendim, për të promovuar dialog dhe për të sfiduar normat shoqërore.

“Filmi ka aftësi unike për të frymëzuar reflektim, nxitur dialog dhe për t’u dhënë zë historive që duhet të dëgjohen,” tha Ambasadori Westerlund. “Jemi shumë të lumtur që mbështesim DokuFest-in dhe këtë nismë të re shumë të rëndësishme.”

Dhe nuk ka të bëjë vetëm me financimin, po aq e rëndësishme është fryma e bashkëpunimit nordik që e frymëzoi atë.”

Westerlund gjithashtu tregoi se kinemaja ka ndikuar në jetën e tij, duke përmendur filma si *Burnt by the Sun*, *In the Heat of the Night* dhe serialin suedez *The Boy with the Golden Pants*, të cilat kanë formësuar pikëpamjen e tij etike që në një moshë të re.

“Kemi mbështetur DokuFest-in për më shumë se 15 vjet,” theksoi ai. “Jam shumë i lumtur që tani gjithashtu mund të frymëzojmë dhe të mbështesim këtë Forum të ri, i cili bazohet në vlerat nordike të partneritetit dhe rritjes së kreativitetit.”

Forum i Filmit të Shkurtër organizohet nga DokuFest në bashkëpunim me Qendrat Kinematografike të Kosovës, të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë; Italian Short Film Center; ShorTo Film Market; Asociacionin e Dokumentarëve të Evropës; AGORA MARKET të Festivalit të Filmit të Selanikut; Square Eyes; transmetuesin publik finlandez YLE; dhe Op-Docs të The New York Times.

Edicioni i parë mirëpret Skocinë si vend mysafir, përmes një partneriteti me Institutin Skocez të Dokumentarit dhe programin e tij *Breaking Borders*. Projektet skoceze do të prezantohen në seancat e procesit të punës së Forumit, duke ndërtuar një themel për bashkëpunime të ardhshme ndërkombëtare.

Forum i Filmit të Shkurtër organizohet nga DokuFest në bashkëpunim me Qendrat Kinematografike të Kosovës, të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë; Italian Short Film Center; ShorTo Film Market; Asociacionin e Dokumentarëve të Evropës; AGORA MARKET të Festivalit të Filmit të Selanikut; Square Eyes; transmetuesin publik finlandez YLE; dhe Op-Docs të The New York Times.

Ndërsa projektet pjesëmarrëse do të garojnë për disa çmime dhe mbështetje nga industria.

Forum i Filmit të Shkurtër mbështetet nëpërmjet Creative Force Program, i financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) dhe Ambasada Suedeze në Prishtinë, së bashku me kontribute vjetore nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës.

Me planin për të zgjeruar pjesëmarrjen në vitin 2026 duke përfshirë edhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, dhe për të mirëpritur një delegacion suedez të producentëve në vitin 2027, Forumi i Filmit të Shkurtër është gati të bëhet një element i përhershëm në ekosistemin kinematografik rajonal, duke nxitur produksione të përbashkëta, duke ndërtuar ura dhe duke shtuar zëra të larmishëm nga e gjithë Evropa Juglindore.

Për gjithë magjinë dhe nostalgjinë

NË BISEDË ME MARKO GRBA SINGH



Si zakonisht, Prizreni mund të jetë plot surpriza, pa asnjë dyshim, por është një kënaqësi e veçantë të shohësh çdo vit fytyra të njohura në rrugët plot kafene të Prizrenit. Kur dritat zbehen dhe e gjithë bota shndërrohet në biseda që i mbajnë njerëzit ulur në tavolina deri në agim. Në këtë atmosferë, DokuDaily u takua me Marko Grba Singh, regjisorin nga Beogradi që e ndjen Prizrenin si shtëpinë e tij, dhe ky është viti i dhjetë radhazi që ai është këtu për festivalin.

Ai nuk është i panjohur me pjesëmarrjen në festival në forma të ndryshme, si regjisor në garë, si anëtar jurie, apo si entuziast i gjithçkaje që sjell DokuFest. Ai thotë:

“Po e shijoj festivalin si çdo vit, dhe mendoj se Prizreni vërtet bëhet qyteti më i mirë në Ballkan në këto ditë, gjatë DokuFestit, dhe i gjithë qyteti kthehet në një karnaval, gjë që është unike për festivalet.”

Grba Singh është këtu me filmin e tij që konkurren në kategorinë Balkan Dox me titull “The Divided City of Mitrovica”, dhe siç thekson ai, titulli mund të tingëllojë informues, por në fakt është një reflektim poetik i përshtypjeve që mori gjatë vizitës dhe njohjes së qytetit. Ai shkoi në Mitrovicë 25 vite pas luftës dhe për të ishte e pashmangshme të mos vërejë gjendjen e ngrirë të komuniteteve të mbështjella me një ndjenjë të huajsimi.

Kur regjisori erdhi për herë të parë në Prizren një dekadë më parë, me ftesë të drejtorit artistik të DokuFest për të shfaqur filmin e tij “Abdul dhe Hamza” mbi dy refugjatë somalezë në Serbi, ishte një mundësi për të zbuluar më shumë nga perspektiva e tij mbi mënyrën se si regjisorët në rajon kanë zhvilluar tregimet e tyre apo kanë ndryshuar fokusin ndër vite.

Ai thotë: “Është normale të ndryshojnë temat me kalimin e viteve, sepse ndodhin gjëra në botë dhe nuk mund të injorohen. Është e pashmangshme që të kesh filma që flasin për tema aktuale dhe të rëndësishme. Pra, në vitin 2015 ishte kriza e madhe e refugjatëve në Evropë, kështu që kishte shumë filma që eksploronin këtë temë, si dhe për Sirinë dhe luftën civile. Pastaj, për fat të keq, filloi pushtimi i Ukrainës. Kështu që, e di, temat ndryshojnë, dhe nuk mendoj se është gjë e keqe. Njerëzit ndonjëherë thonë që është manierizëm të bësh filma për temat aktuale, por mendoj se është thjesht normale, sepse regjisorët dokumentarë tregojnë realitetin dhe realiteti është ajo që po ndodh në botë tani.”

Ai gjithashtu vë në dukje disa nga zhvillimet në skenën kinematografike kosovare, duke përmendur karrierat mbresëlënëse të Norika Sefës, Samir Karahodës dhe Kaltrina Krasniqit, si regjisorë që kanë përfshirë shije, edukim dhe përkujdesje në mënyrën se si bëjnë filma.

Ai gjithashtu vë në dukje disa nga zhvillimet në skenën kinematografike kosovare, duke përmendur karrierat mbresëlënëse të Norika Sefës, Samir Karahodës dhe Kaltrina Krasniqit, si regjisorë që kanë përfshirë shije, edukim dhe përkujdesje në mënyrën se si bëjnë filma.

Ndërkohë, DokuDaily ishte kurioz të pyeste më shumë për përvojën e tij në qytet gjatë festivalit. Ishte momenti i duhur për të kapur një copëz nga ritmi i festivalit që gjithmonë e marrim me vete kur largohemi nga DokuFest. Për Markon, një ditë tipike gjatë festivalit nis, në varësi të asaj se si netët e DokuNights e përcaktojnë orarin. Nëse dita nis herët, qebapat tek Afrimi janë ilaç për shpirt. Në rast se zgjimi është i vonë, rrugët e të gjithëve kryqëzohen te Bar Aca në një pikë të caktuar. Një nga vendet e tij të preferuara është Secret Bar, që në një mënyrë të çuditshme ruan ende një ndjesi nostalgjie që bëhet shtëpi në mënyrë të papërcaktuar në netët e Prizrenit.

Shënim për të gjithë lexuesit e DokuDaily: Marko donte që të vendosnim bastin tonë për çmimin “Leopardi i Artë” në Festivalin e Filmit në Locarno në faqen e Neil Young, i cili gjithashtu ndodhet në Prizren gjatë DokuFestit. Marko po vendos bastin e tij për filmin e Dane Komljen, “Desire Lines”. Mund ta vendosni bastin tuaj [këtu](#).

Ndërkohë që ju ftojmë të shikoni filmin e Markos në kategorinë Balkan Dox së bashku me pjesëmarrje të tjera të shkëlqyera, shpresojmë që të ndjeni të njëjtën gëzim dhe magji që regjisori shprehu gjatë bisedës me DokuDaily. Shihemi në shfaqje të filmave!



MBI DOKUTALKS

Rimarrja e hapësirës publike përmes kulturës



Në frymën e Jürgen Habermas-it, hapësira publike është më shumë se një vend fizik, është arena ku formohet vullneti kolektiv, ku biseda bëhet arterie e demokracisë dhe ku komuniteti i reziston ngadalë humbjes së zërit të tij. Por çfarë ndodh kur kjo hapësirë e brishtë, e fituar me përpjekje dhe gjithmonë nën kërcënim bëhet njëkohsisht edhe fushëbetëje e edhe çmim?

"Ishte një vend magjik, por asgjë nuk mund të ndodhte aty... nëse nuk provonim," nisi fjalën Veton Nurkollari, Drejtor Artistik i DokuFestit, duke hapur DokuTalk-un e mbajtur në Shkollën e Muzikës "Lorenc Antoni" më 3 gusht. Me titullin Hapësira Publike si Rezistencë Kulturore, ky DokuTalk bashkoi Veton Nurkollarin, Valentina Bonizzin, Rozafa Maliqin dhe Luka Knežević Strikan, nën moderimin e Dea Gjinovcit.

Në vitin 2002, kinemaja e vjetër Lumbardhi, në zemër të Prizrenit, qëndronte në heshtje. Dyert e saj ishin të mbyllura, me çati të përkulur nga vitet e neglizhencës. Dikur një perlë kulturore e qytetit, ajo ishte shndërruar në një guaskë të zbrazët. Grupi që më vonë do të niste DokuFestin nuk kishte një plan të gatshëm. Shumica nuk kishin organizuar kurrë një festival. "Nuk kishim asnjë ide si ta vendosnim në jetë", kujton Nurkollari, një nga themeluesit. "Por menduam, nëse mund të tregojmë diçka këtu, ndoshta do të ringjallej sërish".

Ajo shfaqje e parë bëri më shumë se veç të sillte publikun. Ajo ndezi një besim që do të përhapej përtej festivalit: hapësirat publike nuk janë "të tyre", janë tonat! Duke ardhur nga një e kaluar socialiste ku "publike" shpesh nënkuptonte të kontroluar nga shteti, dhe një realitet pasluftë ku privatizimi po përpinte shumicën e peizazhit urban, rikthimi i Lumbardhit ndihej si diçka e madhe. "Nëse ke një ide të mirë dhe jep përpjekje, mund ta rikrijosh një hapësirë," thotë Nurkollari. "Dhe kur ta bësh një herë, e kupton se mund ta bësh sërish, e sërish, edhe në vende të tjera", shton ai.

Pa një kinema të përhershme, DokuFest filloi të transformonte ndërtesa të papërdorura, oborre dhe hapësira të hapura në kinema të përkohshme.

Me kohën, kjo mbuloi qytetin me kulturë, duke treguar se hapësirat e përbashkëta publike mund të rikthehen në jetë. Pa një kinema të përhershme, DokuFest filloi të transformonte ndërtesa të papërdorura, oborre dhe hapësira të hapura në kinema të përkohshme. Me kohën, kjo mbuloi qytetin me kulturë, duke treguar se hapësirat e përbashkëta publike mund të rikthehen në jetë. Ky model u përhap. Në Kamzë, Shqipëri, një qytet që u rrit nga një vend me toka bujqësore në 100 mijë banorë pothuajse brenda natës pas viteve '90, kolektivi ATA nisi në një bodrum.

"Ishin thjesht një grup të rinjsh kureshtarë", tregon Valentina Bonizzi, artiste vizuele, shkrimtare dhe pedagoge. ATA, e themeluar në vitin 2014 nga një grup aktivistësh në Kamzë, krijoi një qendër komunitare që organizon aktivitete shoqërore dhe kulturore nga fusha e artit, gazetarisë, antropologjisë dhe ligjit. Qendra shërben si një nyje për praktika krijuese të rrënjësura në marrëdhënie njerëzore, duke reflektuar një përpjekje më të gjerë për të rimarrë dhe aktivizuar hapësirat publike. Valentina Bonizzi, një nga folëset e DokuTalk-ut, theksoi rëndësinë e këtyre hapësirave si forume të hapura e gjithëpërfshirëse, ku anëtarët e komunitetit mbledhen për të marrë vendime kolektive. Ajo nënvizoi se këto biseda që evoluojnë vazhdimisht adresojnë sfida shoqërore dhe sigurojnë që hapësira të mbetet e qasshme dhe e rëndësishme për të gjitha brezat, duke nxitur rezistencë dhe angazhim kulturor të vazhdueshëm.

Ajo gjithashtu theksoi rëndësinë e të mësuarit nga njëri-tjetri. "Koha është mjaft e rëndësishme në atë për të cilën po flasim. Sepse ajo që kemi mësuar nga DokuFest nuk është vetëm marrja e hapësirës, por këmbëngulja në ndërtimin e praktikave të të pasurit diçka të përbashkët, të ndërtimit të kujtimeve kolektive", tha Bonizzi. Në Beograd, hapësira e vetë-menaxhuar Magacin u bë një tjetër nyje në këtë rrjet informal rezistence. Krejtësisht jashtë kontrollit shtetëror, Magacin funksionon mbi një parim radikal: kushdo në fushën kulturore mund ta përdorë hapësirën falas. Nuk ka qira, nuk ka proces përzgjedhjeje. Vendimet merren kolektivisht në mbledhje mujore.

"Është një nga të paktat vende ku hyrja nuk lidhet me para ose status", thotë Luka Knežević Strika, fotograf, artist pamor dhe punëtor kulturor. "Nëse të duhet hapësira, dërgon një email. Përgjigjja është po". Duke u kthyer në Prishtinë, Rozafa Maliqi, organizatore komunitare, menaxhere kulturore dhe hulumtuese, i sheh hapësirat publike jo thjesht si vende fizike, por si hapësirë për dialog dhe transformim.

Ajo beson se ndryshimi i vërtetë ndodh kur komunitetet guxojnë të përballen me të vërtetat e vështira, qoftë mungesa e zonave miqësore për komunitetin queer, qoftë luftimi i ngacmimeve seksuale dhe t'i sjellin këto çështje në hapësirë publike për diskutim.

Për të, këto hapësira lulëzojnë kur bëhen arena për biseda të sinqerta, ndonjëherë të ashpra, ku përgjegjësia pranohet, duke thurur një strukturë shoqërore më të fortë që i përket të gjithëve. Në këtë mënyrë, hapësirat publike bëhen më shumë sesa vende takimi; ato shndërrohen në katalizatorë të historisë që komuniteti e shkruan vetë e që vazhdon të zhvillohet.

"Mendoj se kjo ka qenë një pikë kyçe ndër vite, sepse shumë breza vijnë dhe sjellin me vete prioritete të ndryshme. Kjo do të thotë që biseda është gjithmonë e gjallë. Gjithmonë ka diçka të re: një sfidë për t'u adresuar", thotë ajo. Por këto iniciativa nuk kanë të bëjnë vetëm me artin. Ato kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtës për t'u mbledhur, për të krijuar, për të ekzistuar së bashku jashtë logjikës së tregut.

Negociatat me autoritetet mund të jenë procese të gjata e frustruese. "Hapësirat publike maten me metra katrorë dhe u caktohet një çmim," shpjegon Nurkollari. "Sillen sikur duhet të jesh mirënjohës që 'të lejojnë' të përdorësh diçka që është e jotja", shton ai.

Disa leje sigurohen pas muajsh bisedimesh; të tjera injorohen derisa ngjarja veç nis. "Ndonjëherë duhet t'u tregosh që mund të bësh diçka edhe pa miratimin e tyre", thotë një tjetër. "Vetëm atëherë të marrin seriozisht."

Teksa bisedës i erdhi fundi, nga çdo deklaratë doli një e vërtetë: hapësira publike nuk "fitohet" njëherë e përgjithmonë. Ajo duhet imagjinuar, debatuar dhe mbrojtur vazhdimisht. Puna është rraskapitëse, shpesh e pasigurt dhe gjithmonë e papërfunduar. Por, në termat e Habermas-it, sfera publike jeton vetëm për aq kohë sa njerëzit vazhdojnë të jenë aty së bashku, për të folur, për të vepruar dhe për të refuzuar heshtjen.

MBI FILMAT

Filmat që flasin ndryshe



FOTO: FERDI LIMANI

KONTAKT Collection në DokuFest

Prizreni në gusht gjithmonë merr frymë ndryshe. Lumi, kinematë e hapura dhe njerëzit nëpër rrugica krijojnë një atmosferë që nuk përsëritet gjatë vitit. Këtë vit, mes shumë programeve të DokuFestit, në bashkëpunim me Autostrada Biennale, KONTAKT Collection, sjell një përzgjedhje të veçantë: 13 filma të shkurtër eksperimentalë, nga vitet '70 deri sot, që flasin për kujtesën, luftën, migrimin dhe përditshmërinë me një gjuhë personale dhe të sinqertë.

Këta filma nuk kanë strukturë tradicionale dhe nuk tregojnë histori në mënyrë lineare. Kompleksiteti i tyre vizual dhe emocional e bën përmbajtjen edhe më të ndjeshme dhe të prekshme. Në bazë të tematikave do t'i ndaja në tre grupe: lufta, migrimi dhe shikimi ndryshe i përditshmërisë.

Lufta dhe gjurmët e saj

Këta filma e sjellin luftën nga brenda jetës së njerëzve, pa zhurmë të madhe, por me një intensitet që të mbetet gjatë.

Sokol Beqiri me Superman (2002) na kthen në izolimin e vitit 1999, duke treguar përpjekjen për të qenë "hero" për familjen, ndërsa frika e brendshme nuk largohet. Rrëfimi i tij shfaqet në barkun e La La nga Teletubbies, ku humori fëmijëror përzihet me traumën. Milica Tomić në Portrait of My Mother (1999) ecën në Beograd pas bombardimeve të NATO-s, drejt shtëpisë së nënës së saj, një aktore në pension që tani punon si tapicere. Një udhëtim i thjeshtë që kthehet në portret të dhimbjes dhe kujtesës.

Ndërsa Kiev (after Lumière) (2021) i Anna Jermolaewa na çon në një treg të qetë pranë hekurudhës, që përmbysset papritur nga një tren i gjatë ushtarak, duke u bërë metaforë e luftës që hyn pa paralajmërim në përditshmëri.

Migrimi dhe jeta e përditshme

Këta filma tregojnë jetën e njerëzve mes dy botëve, mes shtëpisë së vjetër dhe asaj të re, shpesh të ndarë nga migrimi ose nga rrethanat sociale.

Adrian Paci në Albanian Stories (1997) filmon vajzën e tij të vogël që shpik përballë pas shpërnguljes në Itali, ku loja e saj fëmijërore fsheh frikën dhe kujtimet e mërgimit. Želimir Žilnik në Inventur – Metzstraße 11 (1975) vendos kamerën përballë banorëve të një ndërtese në Mynih, punëtorë të huaj nga Jugosllavia, Turqia e Greqia, që tregojnë historitë e tyre të thjeshta e të sinqerta. Glimpse (2016-17) i Artur Żmijewski na çon në kampet e refugjatëve në Berlin, Paris dhe Calais, ku heshtja e imazheve bardhë e zi flet më shumë se çdo dialog për izolimin dhe pritjen pafund.

Shikimi ndryshe i përditshmërisë

Filmat e fundit luajnë me formën dhe e shohin përditshmërinë me sy të ri, duke e kthyer në përvojë kinematografike.

Two Times in One Space (1984) i Ivan Ladislav Galeta vendos të njëjtën skenë familjare dy herë në ekran, me një vonesë të vogël, duke krijuar ndjesinë se koha dhe hapësira përplasen e përsëriten

Walls, Coats, Shadows (1975) i Mladen Stilinović filmon mure gri, pallto të errëta dhe hije që kalojnë shpejt, duke e kthyer përditshmërinë socialiste në një reflektim të heshtur dhe ironik. Rolle-2 (1983) i Dietmar Brehm ndërthur portrete të afërta, gjeste të çuditshme dhe pamje të shkurt-ra lulësh, duke kapur absurditetin e jetës së përditshme. Ndërsa Ashley Hans Scheirl me At This Speed Hairs Are Dashing (1979) dhe Jocasta Emerges (1982) përzien fragmente televizive, peizazhe dhe skena intime të komunitetit queer, duke e kthyer eksperimentin vizual në një rrëfim personal dhe të ndjerë.

KONTAKT Collection është një ftesë për të parë ndryshe dhe për të ndjerë. Këta filma tregojnë si lufta, migrimi dhe përditshmëria hyjnë në ekran në formën më të sinqertë. Janë filma që duhen parë me qetësi dhe nga afër.

Filmat do të shfaqen në këto data:

7 gusht: At This Speed Hairs Are Dashing, Black Film, General Alert (godard), Inventur – Metzstraße 11, Glimpse, Jocasta Emerges, Kiev (after Lumière), Rolle-2, Two Times in One Space, Walls, Coats, Shadows

8 gusht: Albanian Stories, Superman, Portrait of My Mother

Shkruar nga Lendina Balaj

RECENSIONE

Beneath Which Rivers Flow (2025)



Shtratit të lumit i thahet uji, kanoet ndryshken, dhe barërat e gjelbërta zbehen në kafe. Por njerëzit mbeten. Beneath Which Rivers Flow (2025) ndjek Ibrahimin, një banor i moçaleve të Irakut jugor, ndërsa lundron përmes kullotave të zbehta të dëmtuara nga degradimi mjedisor. Udhëtimi i tij nuk ka as fillim e as fund, duke reflektuar tharjen e ngadaltë të vetë peizazhit. E vetmja shenjë ngrohtësie: një buall uji, shoqëruesi i tij i heshtur. Me regji nga Ali Yahya, Beneath Which Rivers Flow përballlet drejtpërdrejt me të vërtetën e pakëndshme të katastrofës ekologjike. Rënia mjedisore nuk shënon vetëm peizazhet fizike, por gjithashtu ndryshon tërësisht mënyrat e jetës. Ndërkohë që kombet e pasura qëndrojnë të mbrojtura nga efektet e saj, popullsitë në Jugun Global përballen me pasojat e shpërbërjes së natyrës. Ibrahim pasqyron këtë të vërtetë, shpesh duke parë drejt në kamerë, sikur të thotë: “Ti, po, ti, e bëre këtë.” Ne, shikuesit, bëhemi bashkëfajtorë në përpjekjen e tij të qetë për të ekzistuar.

Gjuha vizuale e Yahyas përforcon këtë peshë emocionale. Struktura meditative me plane të gjata e lejon shikuesin të marrë frymë në botën e Ibrahimit. Ndërsa horizontet e mjegullta shndërrohen në vegjetacion të thatë të përflakur, tharja ndjehet deri në gojë. Fillimi përkufizohet nga korniza intime: Ibrahim i larë në tone jeshile-blu, i lidhur me tokën përmes një bualli dhe nënës së tij që përgatit bukë të freskët. Kjo butësi kalon në pamje të gjera të terrenit të egër dhe afërsi që ndiejnë dhimbje. Kinematografia nuk është vetëm e bukur, por thellësisht prekëse. Beneath Which Rivers Flow është një film që gjen gravitetin e vet në një të vërtetë pa ngjyrë. Duke evokuar kapitujt e parë të një romani të Hermann Hesse, fillimi jep ndjesinë e një udhëtimi heroik: një njeri dhe një buall që lundrojnë përmes një bote që zhduket. Por këtu nuk ka hark mitik, vetëm realitetin e ftohtë. Nuk ka transformim, vetëm erozion. Kjo stagnim shtrën një pyetje radikale: Në një epokë të kolapsit ekologjik, a është ende i mundur udhëtimi i heroit? Apo mos vallë degradimi mjedisor e ka reduktuar jetën në Jugun Global në një ekzistencë të pastër të mbijetesës?

Shkruar nga Carson Beale

A Want in Her (2024)



Përzgjedhja e DokuFest-it për “A Want in Herj” në kategorinë Ndërkombëtare Feature Dox i dha publikut tonë një vështrim të thellë dhe prekës në jetën e një familjeje që lufton me varësinë ndaj alkoolit. Dëshira e nënës Nauna është alkooli dhe lehtësimi që ai sjell. Dëshira e vajzës, Myrid, është që nëna e saj të jetë e kthjellët. Kjo është një histori e dhimbshme. Të bësh një film të tillë, ku në qendër është nëna jote alkooliste, duhet të ketë qenë zemërthyesë, por ndoshta dhe çliruese. Filmi tregon shkatërrimin që lë pas një anëtar familjeje që vetëshkatërrohet. Siç thotë shprehja, në çdo jetë bie pak shi, por në një pikë, shumë shi shkakton përmbytje. Në këtë film, ne e shohim Myridin teksa rrihet nga stuhia, përsëri e përsëri, dhe bën çmos për të qëndruar e thatë, për të qëndruar e shëndetshme. Filmi gjithashtu e eksploron bukur se sa larg mund të shkojë një vajzë për të shpëtuar nënën e saj. Myrid e kërkon nënën e saj alkooliste kur ajo zhduket, dhe përpiqet ta ndihmojë të kthjellohet kur e gjen. Kjo është prova që ekziston një forcë po aq e fuqishme sa dashuria e një nëne dashuria e një vajze. Zemra e Myridit thyhet për nënën e saj, dhe kjo ndjehet qartë gjatë filmit.

Është e çuditshme dhe e kthyer përmbys, që një vajzë të bëhet nënë e nënës së saj. Por të gjithë e dimë se kjo ndodh në botën tonë, jetë të shkatërruara nga droga dhe alkooli. Zemra na dhemb për Myridin, që jep gjithçka për nënën e saj.

Shkruar nga Scott Hoy

DOKUNIGHTS

Ishte mëse e volitshme që Beatrice Gjergji të hynte në skenë e veshur në të kuqe, duke ecur me elegancë përpara në sfondin e ekraneve që flakërijnë. Pas një sërë vështirësish të vogla teknike në fillim gati sa ndaluan natën e Shkodra Elektronike, ajo e dha përshtypjen e një feniksi që ngrihet nga hiri, duke dhuruar, së bashku me magjistarin e sintetizatorëve Kolë Laca, një performancë madhështore që u përhap nëpër muret prej guri në Sonar Stage dhe më gjerë. Këto ndërprerje fillestare të energjisë nuk e prishën atmosferën, por vetëm vonuan katarsisin: një nga aktet më emocionuese të skenës muzikore shqiptare bashkëkohore që linte gjurmë përballë publikut të zjarhtë të Prizrenit.

Performanca filloi me korin polifonik që ngjallte ndjesinë e diçkaje qiellore për të ndërtuar pritshmërinë, por turma tashmë kishte arritur pikën kulmore duke vërshuar drejt pistës së kërcimit, ndjehej sikur i gjithë Prizreni kishte prituri këtë natë. Pastaj, erdhën tingujt e errët të sintetizatorëve të Lacës, përpara se Gjergji të dilte përpara në skenë, si një figurë eterale. Ajo që pasoi ishte një bas që të tundte thellë në brendi, me dyshen që jo vetëm dëgjohej, por ndihej fuqishëm.

Ndërsa kënga e Eurovizionit "Zjerm" mund të jetë e preferuara e fansave, nuk është ajo që e përcakton Shkodra Elektronike, dhe një sërë këngësh me ritme të forta, sintetizatorë të çuditshëm, ndërtim të tensionit dhe shpërthime ekstazie e vërtetuan këtë. Zëri mahnitës i Gjergjit që notonte mes tingujve elektronikë, kalime të papritura në kërcime me BPM të larta, instrumentale shkodrane të shpërfytyruara dhe të copëtuara, dhe rrahje tribale mes thirrjeve melodike: të gjitha kulmuan në një kaos të bukur në Prizren, me publikun që ushqej me energjinë që kjo dyshe solli në skenë. Kjo dyshe u shoqërua nga kori iso-polifonik që mishëron thelbin e asaj që është Shkodra Elektronike: një festim i lavdishëm i historisë shqiptare, duke e respektuar dhe përvetësuar të kaluarën, ndërsa e refrakton përmes një instrumentimi bashkëkohor dhe përparimtar.

Shndrit, shndrit, shndrit!

Gjergji tregoi një prani të fuqishme fizike në skenë, e veshur me të kuqe, me flokët që valëviteshin në erë, duke dominuar me lëvizjet e saj energjike, përfshirë, po, atë kërcimin karakteristik të "Zjerm". Qasja e Lacës, me një vështrim që sfidonte audiencën, ishte më kërcënuese, por jo më pak imponuese. Dhe prania qiellore e iso-polifonisë, që vendoste formulime të lashta të Jugut shqiptar mbi ritmet dinamike elektronike, të jepte të dridhura.

Nëse nata hapëse e DokuNights kishte të bënte me nisjen e festës, kjo ndjesi ishte më shumë si një përballje me rëndësinë e vet. Si dikush që vjen nga jashtë muzikës dhe kulturës shqiptare, ishte një kënaqësi të shihje të gjithë Kosovën dhe më gjerë të afroheshin pranë skenës, të këndonin tekstet, të kërcenin me ritmet pulsuese si një trup i vetëm. Mbrëmë, kur Shkodra Elektronike luajtën "Zjerm" për herë të fundit, turma arriti një ndjesi kolektive të plotë dhe harmonike.

Festimet vazhduan me një set surprizë nga vetë Leart Rama, bashkëkurator i DokuNights, i cili e mbylli mbrëmjen me ritme të gëzuara për të gjithë ata që ende ndjenin entuziazmin e asaj që sapo kishte ndodhur.

Mbrëmja e kaluar mund të jetë e vështirë për t'u tejkaluar, por nëse dikush mund ta bëjë, është kuarteti ukrainas i muzikës botërore DakhaBrakha, që sjell një stil unik dhe jashtë kësaj bote të quajtur "etno-kaos": një përzierje elementësh kulturorë të formësuar përmes ekspeditave kërkimore. Bashkohuni me ne sonte, dhe shikoni ata teksta "pushtojnë" kalanë përmes një përvoje transhendentale plot kompozime që premtajnë të na ngjethin.

Shkruar nga Gus Edgar-Chan



FOTO: FERDI LIMANI

General Sponsor	Principal Partner	Principal Partner	Golden Sponsor
			
		 	
			
			
  			
			
			
			